



Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L – 144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 5 të Rregullorës QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01. nr.569 të dt. 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 nëntor 2014, merr këtë:

V E N D I M
PËR RISHPALLJEN E ANKANDIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM
TË VEND GJAHISHTES NË RAHOVEC

Neni 1

Me këtë vendim lejohet rishpallja e ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të vend gjahishtës në Rahovec.

Neni 2

Afati për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të vend gjahishtës në Rahovec do të jetë sipas rregullave në fuqi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e komunës së Rahovecit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e aprovimit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës.

01 Nr. 4538
Rahovec, 27.11.2014

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani

